



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES / VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHENDETESISË / MINISTARSTVO ZDRAVSTVA / MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-9996
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	- 38 -
Data: Datum: Date:	20 / 12 / 20 24
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr.206/XII/2024

Datë:20.12.2024

Ministri i Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), nenit 11 paragrafi 1.5 i Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive Shtojca 1 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1, në bazë të shkresës me nr. prot.05-9868 datë 17.12.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I.** Aprovohet Rekomandimi i Departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor nr. Prot. 05-9868 datë 17.12.2024 „Struktura Organizative për Zbatimin e Planit Strategjik për Zhvillimin e Sistemit të Informimit Shëndetësor 2024-2030, Termat e Referencës (TeR).
- II.** Pjesë e këtij Vendimi është Propozimi për „Strukturen Organizative për Zbatimin e Planit Strategjik për Zhvillimin e Sistemit të Informimit Shëndetësor 2024-2030 , Termat e Referencës (TeR
- III.** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Dr.Arben Viti
Ministër i Shëndetësisë

Vendimi i dërgohet:

- Zëvendësministrave;
- Sekretarit të përgjithshëm;
- DSISH;
- DZHSSH;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MSh-së;

**Struktura Organizative për zbatimin e Planit Strategjik për Zhvillimin e Sistemit të
Informimit Shëndetësor 2024-2030
Termet e Referencës (TeR)**

Akronimet

- **AKPPM** – Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
 - **ARC** – Agjencia e Regjistrimit Civil
 - **ASK** – Agjencia e Statistikave të Kosovës
 - **AShI** – Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
 - **DIEKP** – Departamenti për Integritet Europian dhe Koordinim të Politikave
 - **EDKISH** – Ekosistemi Digjital Kombëtar i Informimit Shëndetësor
 - **FSSh** – Fondi Sigurimeve Shëndetësore
-
- **GT** – Grupi Teknik
 - **IKSHPK** – Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
 - **IPD** – Infrastruktura Publike Digjitale
 - **KDSHDK** – Komiteti Drejtues për Shëndetin Digjital të Kosovës
 - **KPSH** – Kujdesi Primar Shëndetësor
 - **MSh** – Ministria e Shëndetësisë
 - **QKTGJ** – Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut
 - **SISH** – Sistemi i Informacionit Shëndetësor
 - **ShSKUK** – Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
 - **TeR** – Termat e Referencës
 - **ZKM** – Zyra e Kryeministrit

Përmbledhje Ekzekutive

Për të zbatuar sistemin unik dhe të integruar të informimit shëndetësor si një prioritet kombëtar, pas aprovimit të Planit Strategjik për Zhvillimin e Sistemit të Informimit Shëndetësor 2024-2030 është krijuar një strukturë organizative e cila do të mbështesë zbatimin efektiv dhe koordinimin ndërmjet trupave menaxhuese dhe ekzekutive. Duke marrë parasysh kompleksitetin e aktiviteteve dhe ndërveprimin ndërmjet tyre, kjo strukturë synon të qartësojë detyrat dhe përgjegjësitë, si dhe të adresojë sfidat kryesore në zbatim.

Struktura organizative për zbatimin e Planit Strategjik për Zhvillimin e Sistemit të Informimit Shëndetësor 2024-2030 është e organizuar në tri nivele kryesore. Qëllimi i përbashkët i këtyre niveleve është krijimi dhe funksionalizimi i një sistemi të unifikuar që adreson detyrat e përcaktuara në strategji.

Në zbatim të Ligjit të shëndetësisë respektivisht të kapitullit IX ku është rregulluar sistemi i informimit shëndetësor, me të cilin është përcaktuar që Ministria siguron themelimin, zhvillimin dhe funksionimin e sistemit unik dhe të integruar të informimit shëndetësor në gjithë sektorin e shëndetësisë, pavarësisht nga forma e pronësisë, lloji i institucionit dhe organizimi i tij, të bazuar në normativa dhe standarde të përcaktuara nga Ministria.

Departamenti i sistemit të informimit shëndetësor në kuadër të Ministrisë ka barrën e kontraktimit për krijimin e sistemeve, mirëmbajtjen e tyre dhe aplikacioneve, menaxhimin e të dhënave, sigurimin e harduerit të nevojshëm për të gjithë përdoruesit në përputhje me planifikimin e të gjitha institucioneve që janë pjesë e sistemit shëndetësor publik, siguron në anën tjetër që sistemet shëndetësore të jenë të qasëshme edhe në institucionet e tjera private edhe publiko private në mënyrë që të gjenerohen raportet për indikatorët kyç në sektorin e shëndetësisë në përputhje me obligimet ligjore edhe obligimet e tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Të gjitha institucionet e sektorit të shëndetësisë qoftë publike në sektorin e shëndetësisë e kanë për obligim të sigurojnë që rrjeti të jetë funksional në institucionet e tyre, të identifikojnë harduer-in dhe të gjithat komponentet e tjera, të bëjnë planifikimin dhe kërkesat me Ministrinë e Shëndetësisë, të gjithë zyrtarët e teknologjisë së informacionit gjithashtu kanë për obligim të ofrojnë këshilla për përdoruesit e sistemeve respektivisht aplikacioneve respektive në institucionin ku ata veprojnë dhe kanë kontratë.

Komiteti Drejtues për Shëndetin Digjital të Kosovës (KDSHDK)

– Ky komitet ka rol drejtues, monitorues, koordinues dhe këshillues për krijimin e një ekosistemi kombëtar të informimit shëndetësor (SISh).

Komiteti Drejtues për Shëndetin Digjital të Kosovës (KDSHDK) ka një rëndësi të madhe për shumë aspekte të sistemit shëndetësor, përfshirë përmirësimin e qasjes, cilësisë dhe efikasitetit. Arsyet kryesore pse krijimi i një mekanizimi të dedikuar për shëndetin digjital është thelbësor:

Përmirësimi i qasjes në kujdesin shëndetësor: Komiteti Drejtues për Shëndetin Digjital të Kosovës (KDSHDK) mund të lehtësojë zhvillimin e mjeteve digjitale, si platformat e telemjekësisë në pajtim me legjislacionin në fuqi, të cilat ndihmojnë në mbulimin e hendekut të qasjes në zonat e largëta ose të nënshërbyera në Kosovë. Kjo u lejon pacientëve të konsultohen me ofruesit e kujdesit shëndetësor pa pasur nevojë të udhëtojnë larg, gjë që është veçanërisht e dobishme në zonat rurale.

Standardizimi i të Dhënave dhe Ndërveprueshmëria: Komiteti Drejtues për Shëndetin Digjital të Kosovës (KDSHDK) luan rol kyç në vendosjen dhe zbatimin e standardeve për shkëmbimin e të dhënave dhe ndërveprueshmërinë ndërmjet ofruesve të kujdesit shëndetësor. Kjo mundëson që sistemet e ndryshme të ndajnë të dhënat e pacientëve në mënyrë të sigurt dhe efikase, duke siguruar vazhdimësinë e kujdesit nëpër institucione të ndryshme të kujdesit shëndetësor.

Përmirësimi i Sistemeve të Informimit Shëndetësor (SISh): mekanizëm qëndror për shëndetin digjital mund të sigurojë që sistemet e informimit shëndetësor të zbatohen, mirëmbahen dhe standardizohen në mënyrë të duhur, duke kontribuar në përmirësimin e saktësisë së të dhënave, regjistrave të pacientëve dhe statistikave shëndetësore më të besueshme që informojnë vendimet për shëndetin publik.

Rritja e Efikasitetit dhe Kursimi i Kostove: Duke dixhitalizuar dhe automatizuar proceset, si regjistrimi i pacientëve, mbajtja e të dhënave dhe faturimi. Kjo jo vetëm që përmirëson efikasitetin operativ, por gjithashtu sjell kursime financiare për sistemin shëndetësor me kalimin e kohës.

Monitorimi i Përmirësuar i Shëndetit Publik: Me një infrastrukturë të fortë për shëndetin digjital, Kosova mund të gjurmojë dhe të përgjigjet më mirë ndaj sfidave të shëndetit publik, si shpërthimet e sëmundjeve ngjitëse, sëmundjeve kronike etj. Regjistrat e shëndetit digjital dhe analiza e të dhënave mund të ofrojnë njohuri kritike për ndërhyrje në kohë dhe formulimin e politikave efektive shëndetësore.

Promovimi i Privatësisë dhe Sigurisë: rekomandon, këshillon në krijimin e politikave për privatësinë/mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë kibernetike specifike për sektorin e shëndetësisë. Kjo është thelbësore për mbrojtjen e të dhënave të pacientëve dhe për të siguruar pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së të dhënave.

Nxitja e Inovacionit në Kujdesin Shëndetësor: Komiteti Drejtues për Shëndetin Digjital të Kosovës (KDSHDK) promovon zbatimin e teknologjive inovative në kujdesin shëndetësor, si diagnostikimi me AI, aplikacionet për shëndet dhe mjetet e monitorimit në distancë. Këto inovacione kontribuojnë në kujdes më cilësor dhe një sistem shëndetësor më adaptues.

Mbështetja e Objektivave të Strategjisë sektoriale shëndetësore 2030 dhe Planit Strategjik për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor 2024-2030: Strategjitë dhe planet strategjike në shëndetësi përfitojnë nga sistemet digjitale të shëndetit duke ofruar të dhëna të besueshme për planifikimin strategjik dhe alokimin e burimeve. Komiteti Drejtues për Shëndetin Digjital të Kosovës (KDSHDK) rekomandon që nismat e shëndetit digjital me qëllimet më të gjera të kujdesit shëndetësor harmonizohen përmes një qasje të unifikuar për përmirësimin e kujdesit shëndetësor.

Komiteti Drejtues për Shëndetin Digjital të Kosovës (KDSHDK) është i domosdoshëm për ofrimin e qasjes strategjike në funksion të modernizimit e infrastrukturës shëndetësore në Kosovë, duke krijuar një ekosistem të mundësuar nga teknologjia digjitale që plotëson kërkesat në rritje për kujdes shëndetësor dhe ofron një bazë për përmirësime të qëndrueshme në shëndetësi në mbarë vendin.

Grupi Teknik (GT)

– Grupi Teknik vepron si një urë lidhëse ndërmjet KDSHDK, organizatave dhe njësisve në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë (MSh). Ky grup ka për detyrë koordinimin e aktiviteteve, adresimin e kërkesave strategjike dhe teknike, dhe përbëhet nga vendimmarrës, ekspertë të teknologjisë dhe shëndetësisë, si dhe ekipe për zbatimin teknik.

Organizatat dhe Departamentet Brenda dhe Jashtë Ministrisë së Shëndetësisë

– Ky nivel përfshin të gjitha organizatat në kuadër të sektorit të shëndetësisë, departamentet dhe njësitë përkatëse në Ministri dhe jashtë MSh që marrin pjesë sipas nevojës. Roli i tyre është përshkrimi i proceseve të punës, ndërlihdja e sistemeve, testimi dhe popullimi i të dhënave. Gjithashtu, njësitë përkatëse mbajnë përgjegjësinë për funksionimin teknik të sistemit.

Kjo strukturë e plotë dhe e ndarë qartë synon të sigurojë zbatim të qëndrueshëm dhe koordinim të vazhdueshëm të Planit Strategjik për Zhvillimin e Sistemit të Informimit Shëndetësor, duke krijuar një sistem të përmbushur me standardet dhe kërkesat specifike të sektorit shëndetësor në Kosovë.




Figura 1 : Organogrami

Ndërprerja, Modifikimi dhe Variacioni i TeR

Termet e Referencës propozohen nga Komiteti dhe miratohen nga Ministri sipas procedurave të përcaktuara nga Rregullorja e Komitetit.

Komiteti Drejtues për Shëndetin Digjital të Kosovës (KDSHDK)

Qëllimi i KDSHDK

Komiteti Drejtues për Shëndetin Digjital të Kosovës (KDSHDK) ka rol këshillues dhe ofron monitorim të vazhdueshëm, drejtim strategjik dhe koordinim të veprimeve për të krijuar një ekosistem të plotë kombëtar të sistemit të informimit shëndetësor (SISH).

Detyrat dhe përgjegjësitë e KDSHDK:

- Propozon hartimin, përditësimin dhe revidimin eventual të Strategjisë së Shëndetit Digjital:** KDSHDK propozon hartimin, përditësimin dhe revidimin eventual të strategjisë të shëndetit digjital dhe planin e zhvillimit të Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH), për drejtimin e përgjithshëm dhe qëllimet afatgjata të shëndetit digjital në Kosovë.
- Drejtimi dhe Monitorimi i Zbatimit të Sistemeve të Informimit Shëndetësor:** Komiteti monitoron zbatimin dhe funksionimin e sistemeve të informimit shëndetësor në pajtim me strategjinë e përcaktuar, ofron këshilla, rekomandime për Departamentin

e sistemit të informimit shëndetësor dhe për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik të SISH-it;

3. **Propozon hartimin e Politikave për Menaxhimin e Informimit Shëndetësor:** KDSHDK do të propozojë politika që udhëheqin menaxhimin e informimit shëndetësor.
4. **Rekomandon opsione për sigurimin e Burimeve Financiare dhe Mbështetjes:** KDSHDK rekomandon sigurimin e fondeve për zbatimin e strategjisë së shëndetit digjital, përfshirë rekomandimin për burimin e fondeve.
5. **Zgjidhja e Çështjeve Strategjike dhe Teknike:** KDSHDK fasilton adresimin e sfidave kryesore të identifikuara nga grupi teknik gjatë zbatimit të Planit të veprimit të Planit Strategjik për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor 2024-2030, dhe brenda fushë veprimit jep rekomandime për zgjidhjen e problemeve të evidentuara.
6. **Koordinimi me Akterët Kryesorë:** udhëzon bashkëpunimin ndërmjet hisedarëve, përfshirë Ministrinë e shëndetësisë, ofruesit e kujdesit shëndetësor, institucionet tjera qeveritare, jo-qeveritare vendore, për të siguruar koordinimin dhe mbështetjen e nismave të shëndetit digjital në pajtim standardet ndërkombëtare.
7. **Mbikëqyrja e Ndërveprueshmërisë dhe Standardeve të të Dhënave:** KDSHDK propozon standardet për shkëmbimin e të dhënave dhe ndërveprueshmërinë e sistemeve, duke siguruar që të gjitha sistemet shëndetësore të Kosovës të funksionojnë në harmoni.
8. **Fuqizimi i Kapaciteteve dhe Trajnimi:** KDSHDK rekomandon programe trajnimi dhe nisma për të rritur aftësitë digjitale të profesionistëve të shëndetësisë dhe të stafit teknik, për të garantuar përdorimin e duhur dhe të sigurt të teknologjive digjitale në sektorin shëndetësor.
9. **Hulumtim dhe Vlerësim:** propozon hulumtime dhe vlerësime për të matur ndikimin dhe efektivitetin e nismave të shëndetit digjital dhe për të informuar vendimmarrjen për zhvillime të ardhshme.

Përgjegjësistë e KDSHDK-rë ndikojnë në krijimin e ekosistemit të qëndrueshëm dhe funksional të informimit shëndetësor në Kosovë, duke siguruar që sistemet digjitale të mbështesin një kujdes shëndetësor cilësor dhe të aksesueshëm për të gjithë qytetarët.

KDSHDK drejtohet nga Ministri i Shëndetësisë ose një zyrtar i deleguar që raporton tek Ministri i Shëndetësisë.

Anëtarësia dhe Kuorumi

- **Kryesuesi:** Ministri i Shëndetësisë ose zyrtari i deleguar
- **Zv.Kryesues:** Departamenti i Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH),
- **Sekretaria:** Departamenti i Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH)
- **Anëtarët:** Përfaqësues nga:

- Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK)
 - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK)
 - Fondi i Sigurimeve Shëndetësore (FSSh)
 - Zyra e Kryeministrit (ZKM)
 - Përfaqësues nga Ministria e administrimit të pushtetit lokal (MAPL)
 - Përfaqësues nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC)
 - Përfaqësues nga Agjencia e Shoqërisë së Informimit (ASHI)
 - Përfaqësues nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
-
- Përfaqësues nga Agjencia për informim dhe privatësi (AIP)
 - Përfaqësues nga Agjencia për Siguri Kibernetike
 - Departamenti Ligjor
 - Departamenti për Planifikim Strategjik Shëndetësor

Komiteti mund të zgjerojë anëtarësinë për organizata ose individë të tjerë në bazë të nevojës. Komiteti do të zhvillojë aktivitetet në bazë të rregullores së punës së funksionimit të tij dhe kjo rregullore do të miratohet nga vetë komiteti. Vendimet merren sipas kuorumit të përcaktuar me rregullore.

Grupi Teknik (GT) për zbatim

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Grupit Teknik (GT):

1. **Adresimi i Kërkesave Strategjike dhe Teknike:** GT është përgjegjës për identifikimin dhe trajtimin e kërkesave që lidhen me zbatimin e strategjisë së shëndetit digjital dhe nevojave teknike që dalin nga kjo strategji.
2. **Hartimi dhe Mbikëqyrja e Standardeve:** GT luan rol në zhvillimin, aprovimin e standardeve për shkëmbimin e të dhënave, ndërveprueshmërinë e sistemeve dhe sigurinë e informimit në sistemet shëndetësore digjitale.
3. **Monitorimi i Komponentëve Softuerik të EDKISH-it:** GT monitoron zhvillimin dhe performancën e komponentëve softuerik të Ekosistemit Digjital Kombëtar të Informimit Shëndetësor (EDKISH) për të siguruar funksionimin efikas dhe të qëndrueshëm.
4. **Sigurimi i Qasjes dhe Mbrojtjes së të Dhënave:** GT përfshihet në zbatimin e praktikave më të mira për mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë, duke u siguruar që informacioni shëndetësor të jetë i sigurt dhe i aksesueshëm vetëm për personat e autorizuar.
5. **Mbikëqyrja dhe Koordinimi i Infrastrukturës Teknike:** GT siguron që infrastruktura teknologjike e nevojshme për funksionimin e sistemeve shëndetësore

digjitale të jetë e përshtatshme dhe funksionale, përfshirë lidhjen me infrastrukturën publike digjitale.

6. **Hartimi i Procedurave standarde të operimit (PSO):** GT harton PSO dhe ofron udhëzime teknike për funksionimin e sistemeve të informimit shëndetësor, duke përfshirë ruajtjen, qasjen dhe shpërndarjen e informimit.
7. **Konsultimi dhe Koordinimi me Akterë të Tjerë:** GT bashkëpunon ngushtë me hisedarë të ndryshëm në fushën e shëndetësisë digjitale, duke përfshirë ekspertë të teknologjisë dhe përfaqësues të institucioneve shëndetësore, për të siguruar që standardet dhe politikat teknike të jenë të harmonizuara.
8. **Përmirësimi i Kapaciteteve Teknike:** GT organizon dhe ofron trajnime për përmirësimin e aftësive teknike dhe digjitale të personelit të përfshirë në zbatimin dhe menaxhimin e sistemeve shëndetësore digjitale.

Objektivat e Grupit Punues Teknik

1. **Mbikëqyrja e standardeve të të dhënave**
 - Miratimi dhe përdorimi i standardeve që mbështesin Planin Strategjik për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor 2024-2030.
2. **Sigurimi i adresimit të nismave strategjike**
 - Angazhimi me standardet dhe organet akredituese kombëtare dhe ndërkombëtare.
 - Hartimi i planit për një EDKISH të ndërveprueshëm.
 - Zbatimi i modelit për menaxhimin e të dhënave dhe qasjes.
 - Zbatimi i ID-së kombëtare për kujdesin shëndetësor.
3. **Zhvillimi i udhëzimeve për EDKISH-në**
 - Standardizimi i të dhënave dhe përkufizimi i teknikave në sektorin shëndetësor.
 - Krijimi dhe miratimi i Identifikuesit Universal të Pacientit.
 - Sigurimi i qasjes dhe standardeve të sigurisë.
4. **Monitorimi i komponentëve softuerik të EDKISH-së**
 - Përdorimi i ndërfaqeve dhe sigurimi i performancës së tyre.
5. **Adresimi i nismave strategjike për regjistrat ndërveprues**
 - Zhvillimi dhe implementimi i regjistrave bazë për sisteme ndërvepruese.
 - Plani strategjik për analizën e të dhënave shëndetësore dhe avancimin e aftësive raportuese.
6. **Hartimi i udhëzimeve për integrimin e EDKISH-së**
7. **Mbikëqyrja e komponentëve infrastrukturorë të EDKISH-së**
 - Përafrimi me Infrastrukturën Publike Digjitale të Kosovës (IPD).

8. Sigurimi i lidhjes në rrjetin qeveritar për institucionet shëndetësore

- Zhvillimi i standardeve për qëndrueshmërinë e institucioneve shëndetësore dhe për të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor.

9. Zhvillimi i udhëzimeve për ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave

- Standardet për ruajtjen dhe menaxhimin e infrastrukturës së serverëve, sigurinë fizike dhe elektronike të të dhënave.

10. Sigurimi i informimit kthyes për KDSHDK-në dhe diseminimi i saktë për anëtarët e Këshillit.

11. Ndërlidhja dhe koordinimi me grupet e tjera punuese

12. Koordinimi me akterët që punojnë në fusha të ngjashme

13. Identifikimi i fushave teknike për zbatimin e Strategjisë së Shëndetësisë Digjitale

14. Përditësimi vjetor i planit të punës për Strategjinë e Shëndetësisë Digjitale

15. Qeverisja e përgjithshme për prezantimin, rishikimin, miratimin dhe funksionalizimin e softuerit të EDKISH-së.

Aktivitetet Kryesore:

1. Aktivitetet e Përgjithshme:

- Takimet e rregullta (së paku një herë në muaj).
- Dokumentimi i takimeve.
- Ofrimi i informimit kthyes për anëtarët e grupit.

2. Zbatimi i Planit strategjik për SISH:

- Rishikimi vjetor i planit të punës dhe afateve kohore.
- Sigurimi i udhëheqjes dhe udhëzimeve për realizimin e qëllimeve.
- Pranimi i raporteve dhe monitorimi i progresit nga anëtarët.

3. Konsultimi me Akterët dhe Ekspertët:

- Koordinimi dhe konsultimi i vazhdueshëm me akterët dhe ekspertët në fushën e shëndetësisë digjitale.

4. Koordinimi i të Dhënave Teknike:

- Menaxhimi dhe koordinimi i të dhënave teknike për zhvillimin e sistemeve të informimit shëndetësor.

Anëtarësia dhe Kuorumi:

Kuorumi i grupit teknik, vlerësohet me shumicë të pjesëmarrjes së pranishme sipas ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

Përgjegjësitë e Grupit Teknik:

1. Mbështetje për Menaxhmentin dhe Administratën:

- Asistenca në zbatimin e politikave dhe udhëzimeve të menaxhimit dhe administratës.

2. Mbështetje në Zhvillimin e Kapaciteteve Administrative:

- Ofrimi i ndihmës për përmirësimin e kapaciteteve administrative të organizatës dhe institucioneve të shëndetësore.

3. Mbështetje në Zhvillimin e Sistemeve Mbështetëse:

- Kontribut në zhvillimin dhe përmirësimin e sistemeve mbështetëse për shëndetësinë digjitale.

4. Mbështetje në Zhvillimin e Sistemeve Bazë Mjekësore:

- Kontribut në zhvillimin e sistemeve bazike mjekësore dhe integrimin e tyre në sistemin e informimit.

5. Mbështetje në Zhvillimin e Sistemeve të Shëndetit Digjital:

- Lehtësimi i përparimit dhe implementimit të sistemeve të shëndetit digjital në nivel kombëtar.

6. Mbështetje në Zhvillimin e Harduerit:

- Asistencë në zhvillimin dhe zbatimin e zgjidhjeve harduerike për sistemet e shëndetësisë.

7. Këshilla për Sigurinë Kibernetike dhe Mbrojtjen e të Dhënave:

- Ofrimi i udhëzimeve dhe mbështetje për përmirësimin e masave të sigurisë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave shëndetësore.

8. Përbërja e grupit teknik kyç: Nëngrupet mund të formohen varësisht nevojave që i vlerëson kryesuesi i Grupit teknik kyç

- **Kryesues-** Drejtori i Departamentit të Sistemit të informimit shëndetësor.
- **Ministria e Shëndetësisë (MSH):** (Administrata e MSH-së, Departamenti i Burgjeve dhe Instituti Special i Shtimes)
- **Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK)**
- **Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut (QKKTGJ)**
- **Agjencia kosovare për pajisje dhe produkte medicinale (AKPPM)**
- **Inspektorati Shëndetësor i Kosovës (nga një përfaqësues për Departament)**
- **Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)**
- **Kujdesi parësor shëndetësor/Komuna e Prishtinës (KPSH)**

- **Fondi i sigurimit shëndetësor (FSSH)**
- **Institucionet Shëndetësore Private dhe Publiko-Private.**

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Zyrtarëve të IT-së dhe Koordinatorëve të SISH-it

1. **Përshkrimi i Procesit të Punës:** Siguron që zhvillimi i sistemeve të jetë në përputhje me kërkesat dhe nevojat e organizatës.
2. **Mbledhja e Kërkesave Teknike:** Mbledh dhe adreson kërkesat teknike për zhvillimin dhe përmirësimin e sistemeve softuerike, dhe i paraqet ato për shqyrtim në Ministrinë e Shëndetësisë (MSh).
3. **Rekomandime për Ruajtjen e të Dhënave dhe Sigurinë e Sistemeve:** Ofron udhëzime për mbrojtjen e të dhënave personale dhe garantimin e sigurisë në përdorimin e sistemeve.
4. **Menaxhimi i Qasjes së Përdoruesve:** Menaxhon dhe administron qasjen e përdoruesve në sistemet përkatëse, duke siguruar që çdo përdorues ka qasje në përputhje me përgjegjësitë dhe detyrat e tij.
5. **Zbatimi dhe Përkujdesja për Infrastrukturën e TI-së:** Siguron zbatimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës IT, duke garantuar funksionimin e saj optimal.
6. **Identifikimi i Nevojave të Rrjetit dhe Planifikimi:** Planifikon dhe identifikon kërkesat për të ruajtur funksionalitetin e rrjetit qeveritar në mënyrë që ai të funksionojë pa ndërprerje.
7. **Planet e Rikuperimit pas Fatkeqësive:** Zbaton dhe mirëmban planet për rikuperimin e sistemeve të TI-së pas ndonjë fatkeqësie, duke përfshirë rikuperimin e harduerit.
8. **Zbatimi dhe Mbështetja e Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH):** Siguron që sistemi i informimit shëndetësor të jetë operativ dhe i qasshëm, duke ruajtur qasshmërinë dhe disponueshmërinë e të dhënave të pacientëve.
9. **Identifikimi i Nevojave për Trajnime Shtesë:** Identifikon mundësitë për trajnime dhe ri trajnime të vazhdueshme për stafin e institucioneve shëndetësore.
10. **Shërbimet e Ndhmës Teknike (Help Desk):** Ofron mbështetje teknike përmes tavolinës së ndihmës për të adresuar çështjet dhe problemet teknike.
11. **Menaxhimi i Projekteve të TI-së:** Menaxhon dhe siguron realizimin efikas të projekteve të teknologjisë së informimit.
12. **Promovimi i Ndërveprimit të Sistemeve:** Lehtëson ndërveprimin dhe integrimin e sistemeve të ndryshme të informimit shëndetësor për një funksionim më efikas.
13. **Identifikimi dhe Adresimi i Vështirësive në SISH:** Identifikon vështirësitë që lindin në SISH dhe adreson ato duke ndjekur rregullat dhe procedurat përkatëse.
14. **Futja e të Dhënave në SISH në Kohë dhe të Saktë:** Siguron që të dhënat të futen në sistemin e informimit shëndetësor në kohë dhe me saktësi.
15. **Bashkëpunimi me Njësitë Rajonale dhe Qendrore të SISH:** Koordinon dhe mbështet bashkëpunimin ndërmjet njësive rajonale dhe qendrore të SISH për një menaxhim më të mirë të të dhënave dhe sistemeve.
16. **Popullimi i Sistemit:** Siguron që sistemi të mbushet me të dhënat e nevojshme, duke respektuar detyrat dhe përgjegjësitë e caktuara për secilin sektor.

17. **Raportimi Standard:** Raporton në përputhje me formatet standard të krijuara nga Drejtoria e SISH (DSISh) për kërkesat për pajisje IT, trajnime dhe sisteme, të cilat do të rivlerësohen nga DSISh në bazë të prioriteteve dhe vlerësimeve aktuale.
18. **Konfidencialiteti i të Dhënave:** Siguron që çdo përdorues të nënshkruajë dokumentin për ruajtjen e konfidencialitetit dhe privatësinë e të dhënave personale shëndetësore, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave.

**Organizational Structure for the Implementation of the Strategic Plan for the
Development of the Health Information System 2024-2030
Terms of Reference (ToR)**

Acronyms

- **KMA** – Kosovo Medicines Agency
 - **CRA** – Civil Registration Agency
 - **KAS** – Kosovo Agency of Statistics
 - **AIS** – Agency for Information Society
 - **DEIPC** – Department of European Integration and Policy Coordination
 - **NDHIE** – National Digital Health Information Ecosystem
 - **HIF** – Health Insurance Fund
-
- **TG** – Technical Group
 - **NIPHK** – National Institute of Public Health
 - **DPI** – Digital Public Infrastructure
 - **DHSCK** – Digital Health Steering Committee of Kosovo
 - **PHC** – Primary Health Care
 - **MoH** – Ministry of Health
 - **NBTC** – National Blood Transfusion Center
 - **HIS** – Health Information System
 - **KHUCS** – Kosovo Hospital University Clinical Service
 - **ToR** – Terms of Reference
 - **OPM** – Office of the Prime Minister

Executive Summary

In order to implement the unique and integrated health information system as a national priority, following the approval of the Strategic Plan for the Development of the Health Information System 2024-2030, an organizational structure has been established that will support effective implementation and coordination between the management and executive bodies. Taking into account the complexity of the activities and the interaction between them, this structure aims to clarify tasks and responsibilities, as well as address the main challenges in implementation.

The organizational structure for the implementation of the Strategic Plan for the Development of the Health Information System 2024-2030 is organized into three main levels. The common goal of these levels is the creation and functionalization of a unified system that addresses the tasks defined under the strategy.

In accordance with the Health Law, respectively Chapter IX, which regulates the health information system, it is determined that the Ministry ensures the establishment, development and functioning of a unique and integrated health information system in the entire health sector, regardless of the form of ownership, type of institution and its organization, based on norms and standards determined by the Ministry..

The Department of Health Information Systems within the Ministry has the responsibility of contracting for the establishment of systems, their maintenance and applications, data management, providing the necessary hardware for all users in accordance with the planning of all institutions that are part of the public health system, on the other hand, ensures that health systems are accessible to other private and public-private institutions in order to generate reports on key indicators in the health sector in accordance with legal obligations and other obligations determined by the legislation in force..

All institutions in the health sector, whether public or private, are obliged to ensure that the network is functional in their institutions, to identify the hardware and all other components, to make planning and requests with the Ministry of Health, all information technology officers are also obliged to provide advice to system users or relevant applications in the institution where they operate and have a contract.

Digital Health Steering Committee of Kosovo (DHSCK)

– This committee has a leadership, monitoring, coordinating and advisory role for the creation of a national health information ecosystem (HIS).

Digital Health Steering Committee of Kosovo (DHSCK) is of great importance for many aspects of the health system, including improving access, quality and efficiency. The main reasons why the establishment of a dedicated mechanism for digital health is essential:

Improving access to healthcare: The Digital Health Steering Committee of Kosovo (DHSCK) can facilitate the development of digital tools, such as telemedicine platforms in accordance with applicable legislation, which help bridge the access gap in remote or underserved areas in Kosovo. This allows patients to consult with healthcare providers without having to travel far, which is particularly beneficial in rural areas.

Data Standardization and Interoperability: The Digital Health Steering Committee of Kosovo (DHSCK) plays a key role in establishing and implementing standards for data exchange and interoperability between healthcare providers. This enables different systems to share patient data securely and efficiently, ensuring continuity of care across different healthcare institutions.

Improving Health Information Systems (HIS): A central mechanism for digital health can ensure that health information systems are properly implemented, maintained and standardized, contributing to improved data accuracy, patient records and more reliable health statistics that inform public health decisions.

Increased Efficiency and Cost Savings: By digitizing and automating processes, such as patient registration, record keeping, and billing. This not only improves operational efficiency, but also brings financial savings to the healthcare system over time.

Improved Public Health Monitoring: With a strong digital health infrastructure, Kosovo can better track and respond to public health challenges, such as outbreaks of infectious diseases, chronic diseases, etc. Digital health registries and data analysis can provide critical insights for timely interventions and the formulation of effective health policies.

Promoting Privacy and Security: recommends, advises on the creation of privacy/data protection and cybersecurity policies specific to the healthcare sector. This is essential for protecting patient data and ensuring compliance with international data protection standards.

Promoting Innovation in Healthcare: The Digital Health Steering Committee of Kosovo (DHSCK) promotes the implementation of innovative technologies in healthcare, such as AI diagnostics, health applications, and remote monitoring tools. These innovations contribute to better quality care and a more adaptive healthcare system.

Supporting the Objectives of the Health Sector Strategy 2030 and the Strategic Plan for the development of Health Information System 2024-2030: Strategies and strategic plans in health benefit from digital health systems by providing reliable data for strategic planning and resource allocation. The Digital Health Steering Committee of Kosovo (DHSCK) recommends that digital health initiatives are aligned with broader healthcare goals through a unified approach to improving healthcare.

The Digital Health Steering Committee of Kosovo (DHSCK) is essential for providing a strategic approach to modernizing the health infrastructure in Kosovo, creating an ecosystem enabled by digital technology that meets the growing demands for healthcare and provides a foundation for sustainable improvements in health across the country.

Technical Group (TG)

– The Technical Group acts as a bridge between the DHSCK, organizations and units within the Ministry of Health (MoH). This group is tasked with coordinating activities, addressing strategic and technical requirements, and is comprised of decision-makers, technology and health experts, and technical implementation teams.

Organizations and Departments Inside and Outside the Ministry of Health

– This level includes all organizations within the health sector, relevant departments and units within the Ministry and outside the Ministry of Health that participate as needed. Their role is to describe work processes, interconnect systems, test and populate data. Also, the relevant units are responsible for the technical system functioning.

This complete and clearly divided structure aims to ensure sustainable implementation and continuous coordination of the Strategic Plan for the Development of the Health Information System, creating a system that meets the standards and specific requirements of the health sector in Kosovo.




Figure 1: Organizational chart

Termination, Modification and Variation of the ToR

The Terms of Reference are proposed by the Committee and approved by the Minister according to the procedures set out in the Committee's Regulations.

Digital Health Steering Committee of Kosovo (DHSCK)

The purpose of the DHSCK

The Digital Health Steering Committee of Kosovo (DHSCK) has an advisory role and provides ongoing monitoring, strategic direction, and coordination of actions to create a complete national ecosystem of health information system (HIS).

Duties and responsibilities of the DHSCK:

- 1. Proposes the drafting, updating and eventual revision of the Digital Health Strategy:** DHSCK proposes the drafting, updating and the eventual revision of the digital health strategy and the Health Information System (HIS) development plan, for the overall management and long-term goals of digital health in Kosovo.
- 2. Management and Monitoring of the Implementation of Health Information Systems:** The Committee monitors the implementation and functioning of health information systems in accordance with the defined strategy, provides advice, recommendations to the Department of Health Information System and Strategic Management and Planning of HIS;
- 3. Proposes the drafting of Health Information Management Policies:** DHSCK will propose policies that guide health information management.
- 4. Recommends options for securing financial resources and support:** The DHSCK recommends securing funds for the implementation of the digital health strategy, including a recommendation for the source of funds.
- 5. Resolving Strategic and Technical Issues:** DHSCK facilitates addressing the key challenges identified by the technical group during the implementation of the Action Plan of Strategic Plan for the development of Health Information System 2024-2030, and within its scope gives recommendations for solving the identified problems.
- 6. Coordination with Key Stakeholders:** guides collaboration between stakeholders, including the Ministry of Health, healthcare providers, other governmental, non-governmental and local institutions, to ensure coordination and support of digital health initiatives in accordance with international standards.
- 7. Oversight of Data Interoperability and Standards:** DHSCK proposes standards for data exchange and systems interoperability, ensuring that all of Kosovo's health systems function in harmony.
- 8. Capacity Building and Training:** DHSCK recommends training programs and initiatives to increase the digital skills of health professionals and technical staff, to ensure the appropriate and safe use of digital technologies in the health sector.

9. **Research and Evaluation:** proposes research and evaluations to measure the impact and effectiveness of digital health initiatives and to inform decision-making for future developments.

